EVOKED

ARCHITECTURAL DIPTYCHS

EVOKED

ARCHITECTURAL DIPTYCHS

FAB GALLERY UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANA 2016
22 FEBBRAIO > 06 MARZO

AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

ISTITUTO italiano DI CULTURA TIRANA

dicar
Politecnico di Bari

INTBAU
ALBANIA

ah arch puglia


Hyrje

Qëllimi i ekspozitës është hulumtimi i banesave informale të ndërtuara në mënyrë të pakontrolluar në bregdetin shqiptar pas rënies së regjimit komunist në vitin 1991.
Aktiviteti ndërtimor i paligjshëm e i pakontrolluar, i cili u zhvillua gjatë periudhës të tranzicionit - për shkak të paqëndrueshmërisë politike, është kryesisht rezultat i fenomenit të migrimit të brendshëm nga zonat rurale drejt bregdetit dhe qyteteve të mëdha të Shqipërisë.
Ndërtesat, zakonisht të vendosura në tokë bujqësore dhe të realizuar me një skelet betoni, janë shpesh të papërfunduara ose të banuar pjesërisht edhe për shkak të kushteve ekonomike të familjes. Të cilat varen kryesisht nga ndihma e të afërmve, të emigruar jashtë vendit.
Mos përfundimi i ndërtimit dhe procesi i veçantë i okupimit të strukturave ka çuar në një imazh të ri të peizazhit shqiptarë, sidomos në bregdet.
Nëpërmjet angazhimit të arkitektëve italianë dhe shqiptarë do të ekspozohen një seri punimesh me vizionet e fenomenit, të zhvilluara mbi bazën e dokumentacionit fotografik, për të nxjerrë në pah nivelin kritik ne të cilin ndodhet peizazhi sot dhe për të përcaktuar strategjitë projektuese të mundshme.


Për informacione të mëtejshme ju lutem referojuni studimit:
Informal Urban Development in Europe - Experiences from Albania and Greece
Copyright © United Nations Human Settlements Programme (UN-HABITAT), 2010

https://www.fig.net/resources/publications/gltn_unhabitat/un-habitat_informal_urban_dev.pdf

Source www.tradingeconomics.com | Institute of statistics (instat)



Source Eurostat Comext



Ekspozita

EVOKED është një hulumtim mbi procesin e ndërtimeve individuale dhe marrëdhënies të tyre me peizazhin. Këto ndërtesa fitojnë nga njëra anë vijën e horizontit mbi det, nga ana tjetër një pikëpamje ekskluzive mbi vargjet malore.

Sot ndërtesat e papërfunduara apo të banuara pjesërisht kërkojnë një reflektim mbi modelin e strehimit dhe mbi mënyrën e të qëndruarit brenda peizazhit. Me një kërkim të përbashkët mendohet të hapet një konfrontim mbi këtë temë dhe për të kuptuar potencialin e këtyre objekteve. Nëpërmjet observimit dhe absorbimit të degradimit mendohet dhënia e një dinjitet të ri mjedisor dhe formal.

Metoda e përzgjedhur është ajo e mbledhjes dhe ekspozimi i punimeve të 16 arkitektëve shqiptarë dhe 16 arkitektë italianë të njohur të cilët përballen me të njëjtin objekt të fotografuar nga një autor shqiptar. Ekspozita konfigurohet në formën e diptik-ut, nëpërmjet të cilit objekti i fotografuar ka dy projeksione figurative të ndryshme.

Është parashikuar një konferencë për shtyp me pranin e autoriteteve shqiptare, prezantimi i botimit, profil facebook dhe twitter.


Vendi

Ekspozita do të zhvillohet në Tiranë, në galerinë FAB (në afërsi të ndërtesës të Akademisë të Arteve) dhe do të përurohet në fund të shkurtit.

Ekspozita do të shfaqet më vonë në **Bari** dhe **Rome**.



Punimet
Punimet mund të realizohen në format dixhital ose me dorë, me çfarëdo lloj teknike, brenda formatit të përcaktuar nga ekspozita.
Çdo arkitekt do të ketë një foto me kualitet të lartë imazhi, të cilën mund ta shtypi (printojë) në çdo lloj suporti dhe në mënyrën që preferon.
Sipërfaqja ku do të punohet është parashikuar të jetë 50cmx50cm, pa konture.
Sipërfaqja e punës mund të përdoret e gjitha ose pjesërisht.
Punët do të ekspozohen me një kornizë të bardhë druri, me përmasa 2cm, dhe me xham mbrojtës.
Pjesëmarrja në ekspozitën e Tiranës, i jep të drejtën kuratorëve të ekspozojnë punimet e arkitektëve edhe në ekspozitat e tjera të ardhshme deri në fund të vitit 2017.



Riprodhimi i punëve do të publikohen në botimin EVOKED.
Duhet të ketë të paktën përmasat 21x21cm, 300dpi në format dixhital.
Çdo autor është përgjegjës për përmbajtjen e krijimit të tij.
Kërkohet akordimi me kuratorët e ekspozitës për mënyrën e dorëzimit të punës.

Datat e afateve
Data finale e dorëzimit të punëve origjinale.....**15/01/2016**
Riprodhimi i punës me kualitet të lartë të imazhit.....**12/12/2015**
Teksti 2000 fjalë.....**12/12/2015**
Biografi e shkurtër me 300 fjalë.....**12/12/2015**

Për çdo vështirësi logjistike që mund t'Ju lindi, Ju lutem kontaktoni organizatorët.


Prezantimi i ndërtesave
Fotografimet janë realizuar në verën e 2015, të lokalizuara nga Shëngjin deri në Vlorë. Ato përfshijnë ndërtesa të papërfunduara, të pakompletuara ose pjesërisht të banuara. Tregojnë historinë e një fenomeni të shpërhapur dhe të dukshëm nga brezi bregdetar.
“Qeliza” minimale, sipas kohës dhe mjeteve të secilës familje, mund të shtohet e zhvillohet me dhoma dhe shkallë të tjera.
Çdo ndërtesë është një tekst që ngjall shkrime pa fund.


Përshkrim i shkurtër
1. Qarkullimi
Përgjigjet kërkesës për lidhjen e hapësirave të banimit. Pozicioni dhe kualiteti i lidhjeve vertikale rezulton vendimtar në përkufizimin e hapësirës së ndërtesës. Mund të jenë të brendshme, në interier, ose të shtuara në eksterier.
Shkallë të shtuara
Rampë e brendshme
Rampë e jashtme
Rampë e brendshme me konsol.


2. Hapësira të jashtme të banesës
Janë hapësirat e jashtme që hyjnë në përdorimin e banesës dhe kanë një raport të drejtpërdrejtë me kualitetin e kontestit.
Oborr i brendshëm
Oborr
Lozhë
Portikë


3. Fasada
Prezanton qëllimin e familjes që e ka ndërtuar. Në rastin e aktiviteteve tregtare ose të një punishte familjare, është elementi që më mirë duhet të komunikojë këtë shërbim.
Thelbësore është lidhja që krijohet me rrugën automobilistike.

4. Zgjerimi vertikal
Etapat e tjera të ndërtimeve informale janë menduar që në të ardhmen të zhvillohen në vertikale. Në fillim përdoret i parë, sipër nivelit të rrugës. Niveli “i mirë”, ngrihet nga niveli i tokës për nevoja funksionale (poshtë vendosen mjetet e punës) ose klimaterike (përmbytje periodike).
Nga kati i dytë, ndërtesa konfigurohet si strukturë e hapur që mund të shumëfishohet vertikalisht, në lartësi sipas nevojës së familjes që e banon.
Detajet janë shpesh të përfunduara vetëm në katin e parë.









Me kontributin e:
Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit
Insitutit Italian të Kulturës në Tiranë
Universitetit Politeknik të Barit-DICAR Departamenti i shkencës së inxhinierisë së ndërtimit dhe arkitekturës.
INTBAU Albania-International Network for Traditional Building, Architecture & Urbanism IN/ARCH Puglia- Istituto Nazionale di Architettura

Kuruar nga
Domenico Pastore
Frida Pashako
Adelina Greca
Anna Bruna Menghini
Giuseppe Resta

Fotograf
Albes Fusha

Përgatitja grafike
Mariagrazia Panunzio

Inphografic
Marson Korbi
Vito Quadrato

Përpunimi Video
Marson Korbi

Contatti

ITA
info@dpastudio.it
+39 3408237601

AL
info@planifikimi.gov.al
+355 42272556














TRAKTORA
MOTORRA


AUTO
"E L I"









